



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 774, datë 15.12.2021

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.212, DATË 11.3.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT
TË OBJEKTEVE ARSIMORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pika 2.1, e vendimit nr.212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2.1 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2021, të jetë në masën 4 886 106 464 (katër miliardë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Bashkisë Tiranë i transferohet në formën e transfertës së pakushtëzuar fondi, në masën prej 4 839 106 464 (katër miliardë e tetëqind e tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh pa TVSH;
- b) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", të programit

06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 47 000 000 (dyzet e shtatë milionë) lekësh pa TVSH.

2. Efektet financiare të përballohen nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2021.
3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6201/2
DATË 16.12, 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFOMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
BASHKSË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAJ

